

PARLAMENTI I PARË RURAL SHQIPTAR

Nën kujdesin e Kryetarit të Kuvendit,
Z. Gramoz Ruçi

28-30 shtator 2017
Tiranë, Shqipëri



PROGRAMI

Parlamenti i parë rural shqiptar

Nën kujdesin e Kryetarit të Kuvendit,
Z. Gramoz Ruçi

Një projekt Evropian...

E artikulluar si një ide para një viti, “Parlamenti Rural” u shndërrua në një projekt ku të gjithë filluan të besojnë e tashmë po nis të kthehet në një praktikë gjithëpërfshirëse për të nxitur dhe ndërmarrë nga poshtë lart reforma të domosdoshme që synojnë rigjallërimin dhe rilindjen e zonave rurale.

Nisma e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD) për një “Parlament Rural” si instrument për të mbështetur idenë evropiane në zhvillimin rural është jo vetëm një projekt zhvillimi ekonomik dhe social në zonat rurale të vendit, por njëherazi dhe fuqishëm ai është edhe një projekt demokracie.

Mbështetja në partneritetin publik-privat, sensibilizimi dhe përfshirja e çdo qytetari në planet e zhvillimit të Grupeve Lokale të Veprimit (GLV), bashkëpunimi dhe rrjetëzimi mes aktorëve, përfshirja e grave dhe të rinjve dhe mbështetja në ndërveprimin mes qeverisjes vendore, sipërmarrjes ekonomike dhe shoqërisë civile e kthejnë këtë sipërmarrje në një projekt të pazëvendësueshëm zhvillimi të qëndrueshëm. Një gjë e tillë synon që në çdo zone të vendit të ngrihen dhe funksionojnë struktura partneriteti tri-palëshe të afta për të vënë në lëvizje komunitetet vendore në funksion të zhvillimit dhe, si të tilla, të jenë në gjendje të përthithin asistencën e Bashkimit Evropian në vitet në vazhdim.

Parlamenti Rural synon të sensibilizojë dhe mbështesë çdo përpjekje për të kapur ritmin e kohës në politikat dhe praktikat e zhvillimit rural përmes një qasjeje nga poshtë-lart. Përmes ANRD, Parlamenti Rural do të shtrihet në të gjithë vendin dhe së shpejti do të decentralizohet në katër forume rajonale, të cilat do të shërbejnë njëherazi edhe si parlamente rurale rajonale. Ky aktivitet dy ditor hedh bazën për një sinergji rajonale të aktorëve publikë, biznesit rural, dhe shoqërisë civile.

Të gjitha këto dëshmojnë se ANRD mirëpret dhe po punon vazhdimisht me synimin drejt muajit shtatorit të vitit 2019 kohë kur do të mbledhet edhe Parlamenti i Dytë Rural, në të cilin do të bëhet një vlerësim i arritjeve të deritanishme dhe do të nxiten e forcohen më tej ato. Deklarata Përfundimtare e Parlamentit të Parë Rural që do të lexohet në sallën e Kuvendit të Shqipërisë më datën 30 shtator është sfida jonë për dy vitet e ardhshme.

Por, duke iu kthyer axhendës aktuale, do të doja të falenderoja të gjithë kontribuesit e kësaj nisme: Së pari, pa partneritetin e shkëlqyer me Universitetin Bujqësor të Tiranës ky aktivitet nuk do të kishte arritur në këto nivele dhe as nuk do të kishte këtë autoritet. Pa mbështetjen e të gjithë donatorëve dhe mbështetësve kjo nismë do të mbetej thjesht një ide bukur. Së fundi, pa kontributin e të gjithë anëtarëve të ANRD-së kjo nismë do të ishte e pamundur.

Më lejoni në fund të ndaj me ju diçka personale nga kjo përvojë. Gjatë pothuajse 20 viteve përvojë në poste drejtuese në këtë sektor, asnjë organizim nuk ka qenë më i lehtë sesa realizimi i këtij aktiviteti. Kjo gjë vjen për faktin se kjo përvojë nga fillimi deri në fund ishte e hapur, informuese dhe gjithëpërfshirëse duke ndarë me të gjithë aktorët dhe faktorët e kësaj nisme kontributet, meritat dhe përgjegjësitë.

Ju falenderoj dhe vazhdoni të qëndroni me ANRD.

Sotiraq Hroni

Kryetar i Bordit,
Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural

Përshkrim i shkurtër

Parlamenti i Parë Rural Shqiptar (PRSH 1) përfaqëson një platformë advokuese, ndërtimi kapacitetesh dhe rrjetëzimi dedikuar zhvillimit rural. Parlamenti rural – një përpjekje e përbashkët e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD) i përbërë nga njëzet e dy organizata lokale të shoqërisë civile, në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT) – do të mirëpresë rreth 300 pjesëmarrës. PRSH është instrumenti përmes të cilit Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës kërkojnë të influencojnë axhendën e zhvillimit rural në Shqipëri. Partneriteti ndërmjet AUT dhe ANRD do të mundësojë arritjen e qëllimeve të tilla, duke nxitur politikëbërjen e zhvillimit rural bazuar në evidencë dhe kërkim. Përfituesit kryesor të kësaj përpjekje advokuese janë institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe aktorë të tjerë publik dhe privat, organizatat e shoqërisë civile, fermerë, sipërmarrës në fushën e zhvillimit rural etj.

Qëllimi kryesor i këtij instrumenti - Parlamenti Rural - është të advokojë për zhvillimin rural në Shqipëri, dhe të sigurojë që axhenda rurale dhe prioritetet e saj do të reflektohen në politikat lokale, rajonale dhe kombëtare.

PRSH 1 do të sjellë së bashku një rang të gjerë aktorësh rural me qëllim përshpejtimin e proceseve reformuese në zhvillimin rural të vendit në përafrimin me politikën e BE-së të Zhvillimit Lokal të udhëhequr nga Komuniteti (CLLD). Për këtë qëllim, PRSH 1 do të ofrojë një hapësirë e cila synon shkëmbimin e eksperiencave dhe transferimin e njohurive dhe kapaciteteve në lidhje me zbatimin e qajses LEADER/CLLD nga vende të ndryshme europiane dhe ato në rajon.

Platforma e dakortësuar nga aktorët e interesit të këtij partneriteti do të kërkojë të bëjë qeverisjen e institucioneve publike të sektorit në nivel kombëtar dhe lokal më proaktive dhe të përgjegjshme në promovimin e politikave dhe praktikave të BE-së në zhvillimin rural.

Një historik i shkurtër

- Ideja për të organizuar Parlamentin Shqiptar u artikulua në Konferencën kombëtare lançuese të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural më 11 Mars, 2016. Konferenca kombëtare “Përfshirja e Aktorëve Jopublik në Axhendën Kombëtare Rurale” u fokusua në qasjen themeluese të RRjetit, atë me orientim nga poshtë-lartë, si dhe në identifikimin e sfidave që lidhen me bashkëpunimin midis aktorëve public dhe jo-public në zhvillimin rural.
- Event i promovues i Parlamentit të parë Rural Shqiptar u organizua më 14 prill 2017, në ambientet e Universitetit Bujqësor të Tiranës. Ky event solli bashkë akademikë, organizata të shoqërisë civile dhe anëtarë të Rrjetit, përfaqësues të agjensive të zhvillimit rajonal, aktorë të tjerë të interesit të zhvillimit rural dhe studentë të fakulteteve të ndryshme të Universitetit. Një platformë e sfidave të zhvillimit rural dhe çështjet kritike u dakortësua nga pjesëmarrësit;

- Në vijim të Eventit promovues të Parlamentit, gjashtë tryeza rajonale janë organizuar në nivel rajonal me qëllimin e konsultimit të platformës së sfidave të zhvillimit rural në vend me të gjithë aktorët në nivel rajonal dhe lokal.
- Ashtu sikurse rrjetet e tjera europiane dhe rajonale, ANRD synon të organizojë Parlamentin Rural Shqiptar në interval dy-vjeçar, me qëllim që aktorët e zhvillimit rural të advokojnë për politika dhe mbështetje nga ana e qeverisë në përmbushje të sfidave të zhvillimit rural të vendit.

Pjesëmarrësit

- Parlamenti i Parë Rural Shqiptar do të sjellë së bashku rreth 300 përfaqësues të autoriteteve publike lokale, sektorit privat, shoqërisë civile, komunitetin e donatorëve, botën akademike si dhe grupe formale dhe informale të komuniteteve lokale rurale mbarë vendit;
- 61 bashkitë e vendit do të përfaqësohen me zyrtarët vendor, fermerët dhe agjentë të ndryshëm ekonomik dhe social;
- Zyrtarë qeveritarë të autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale; agjencitë rajonale të zhvillimit, donatorët dhe akademikët, ekspertët dhe student;
- Përfaqësuesit e rrjeteve të zhvillimit rural nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë dhe aktorë të tjerë të interesuar në vend dhe rajon;
- Të ftuar dhe ekspertët ndërkombëtarë në fushën e zhvillimit rural.

Formati

Programi i Parlamentit të parë Rural Shqiptar përbëhet nga sesione plenare, panele diskutimi, ëorkshope dhe grupe pune, duke krijuar mundësi për rrjetëzime, ofruar një mundësi të mirë për të iniciuar diskutime, bashkëpunime, transferim njohurish dhe shkëmbim eksperiencash/përvojash dhe praktikash më të mira në lidhje me zhvillimin rural - në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.

Dita 1 | E enjte, 28 Shtator 2017

Vendi: Universiteti Bujqësor i Tiranës

Godina A, Kat.1 Salla “Behar Male”

09.00	Ardhja e delegatëve & Regjistrimi i pjesëmarrësve / Kafja e Mirëseardhjes
10.00	Fjala Hyrëse MIRËSEARDHJE & Fjalë përshëndetëse
10.30-12.30	SESSION PLENAR: Debati aktual mbi zhvillimin rural. Sfidat dhe çështjet kryesore Godina A, Kat.1 Salla “Behar Male”
12.30	Pushim dreke
14:00	WORKSHOPE simultane TEMATIKE–Qasja shumëaktorëshe dhe ndërsektoriale e zhvillimit rural

Workshop Tematik 1 Zinxhirët e vlerës për zhvillimin rural në territoret lokale shqiptare (Salla: 304B)	Workshop Tematik 2 Roli i akademisë dhe institucioneve kërkimore në zhvillimin e politikave rurale bazuar në evidence (Salla: 305B)	Workshop Tematik 3 Roli i shoqërisë civile në zhvillimin rural dhe përfshirjen sociale të komuniteteve rurale (Salla: 306B)
Workshop Tematik 4 Fermat familjare: alternativa për një jetesë rurale të qëndrueshme dhe zhvillim më të barabartë (Salla: 307B)	Workshop Tematik 5 Diversifikimi i ekonomisë lokale (sipërmarrjet rurale, agroturizëm, slow-food etj – sfidat dhe mundësitë) (Salla: 308B)	Workshop Tematik 6 Zhvillimi lokal me pjesëmarrje, endogjen dhe me qasje nga poshtë-lart (Salla: 309B)

16:00-17:30	Transferimi i njohurive dhe shkëmbimi i eksperiencavambi Grupet Lokale të Veprimit LEADER LAG - rrugëtimi drejt zbatimit të qasjes LEADER në Shqipëri (Raundi 1)
19.30	Darka dhe RRJETËZIM

Workshop LEADER LAG 1: LAG Posavje, SLLOVENI Moderator: Janja Jordan (Salla: 304B)	Workshop LEADER LAG 2: LAG Srijem, KROACI Moderator: Albert Varga (Salla: 305B)	Workshop LEADER LAG 3: LAG Maiella Verde, ITALI Moderator: Carlo RICCI (Salla: 306B)
Workshop LEADER LAG 4: LAG Prlekija, SLLOVENI Moderator: Goran Soster (Salla: 307B)	Workshop LEADER LAG 5: LAG Izvor, KROACI Moderator: Matija Zamljačanec (Salla: 308B)	Workshop LEADER LAG 6: LAG Deliblatska Peščara LAG 321 Čoka, SERBI Moderators: Ivana Stefanović & Boris Ilic (Salla: 309B)

DITA 2 | E premte, 29 shtator 2017

Vendi: Universiteti Bujqësor i Tiranës

Godina A, Kat.1 Salla “Behar Male”

09.30	Regjistrimi i pjesëmarrësve
10.00	SESSION PLENAR: Godina A, Kat.1 Salla “Behar Male”
11.15	Pushim kafe
11.45	Transferimi i njohurive dhe shkëmbimi i eksperiencave mbi Grupet Lokale të Veprimit, LEADER LAG - rrugëtimi drejt zbatimit të qasjes LEADER në Shqipëri (Raundi 2)

Workshop LEADER LAG 1: LAG Posavje, SLLOVENI Moderator: Janja Jordan	Workshop LEADER LAG 2: LAG Srijem, KROACI Moderator: Albert Varga	Workshop LEADER LAG 3: Iniciativa LEADER në rajonin Göttinger, GjERMANI Moderator: Jan Hanisch
<i>(Salla: 304B)</i>	<i>(Salla: 305B)</i>	<i>(Salla: 306B)</i>
Workshop LEADER LAG 4: LAG Prlekija, SLLOVENI Moderator: Goran Soster	Workshop LEADER LAG 5: LAG Izvor, KROACI Moderator: Matija Zamljačanec	Workshop LEADER LAG 6: LAG Deliblatska Peščara LAG 321 Čoka, SERBI Moderators: Ivana Stefanović & Boris Ilic
<i>(Salla: 307B)</i>	<i>(Salla: 308B)</i>	<i>(Salla: 309B)</i>

13.30	PUSHIM DREKE
14.30 - 17:00	Katër GRUPE PUNE simultane – aktorët rajonal dhe vendor inicijojnë diskutimin rreth zbatimit të Leader/CLLD bazuar në katër zonave e zhvillimit rajonal

GP1. Zona e Zhvillimit Rajonal 1 (Shkodër-Kukës-Lezhë) Moderator: Roland Bardhi	GP2. Zona e Zhvillimit Rajonal 2 Iniciativa (Tiranë, Durrës, Dibër) Moderator: Shefqet Bruka
<i>(Salla: 305B)</i>	<i>(Salla: 306B)</i>
GP3. Zona e Zhvillimit Rajonal 3 (Korçë-Elbasan-Berat) Moderator: Petrit Dobi	GP4. Zona e Zhvillimit Rajonal 4 (Vlorë-Fier-Gjirokastër) Moderator: Evelina Azizaj
<i>(Salla: 307B)</i>	<i>(Salla: 308B)</i>

15.30	Pushim kafe
17.00	Finalizimi i DEKLARATËS së Parlamentit të parë Rural Shqiptar2017
19.30	Darka dhe RRJETËZIM

DITA 3 | E shtunë, 30 shtator 2017

Vendi: Parlamenti Shqiptar

Sesion Përmbyllës

10.00 FJALA e hapjes
Leximi i DEKLARATËS së Parlamentit të Parë Rural Shqiptar

10:45 MESAZHET kryesore

DITA 1 E ENJTE, 28 SHTATOR 2017

VENDI: UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
Godina A, Kat.1 Salla “Behar Male”

09.00 Ardhja e delegatëve & Regjistrimi i pjesëmarrësve
Kafja e Mirëseardhjes

10.00 Fjala Hyrëse

Evelina Azizaj, Koordinatorë Kombëtare, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural

MIRËSEARDHJE& Fjalë përshëndetëse

Prof.Dr. Bahri Musabelliu, Rector, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Niko Peleshi, Ministër, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Marius Lazdinis, Nën/kryetar, Njësia e Asistencës së Para-aderimit, Drejtoria e përgjithshme e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Komisionin Europian (DG Agri), Komisioni Europian

Maren Kneller, Shefe e Bashkëpunimit për Zhvillim, Ambasada Gjermane

Kirsten Birke Lund, Përfaqësuese e Komitetit Drejtues të Parlamentit Rural Europian

Andi Seferi, Nën/Kryetar, Bashkia Tiranë

10.30 - SESION PLENAR: Debati aktual mbi zhvillimin rural. Sfidat dhe çështjet kryesore

12.30 Moderator: Drini Imami

Sotirag Hroni, Kryetar Bordi, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural

Marius Lazdinis, Nën/kryetar, Njësia e Asistencës së Para-aderimit, Drejtoria e përgjithshme e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Komisionin Europian (DG Agri), Komisioni Europian

Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, Dekan, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Përfaqësues i lartë i Dep. të Strategjisë dhe Koordinimit të Donatorëve, K. Ministrave

Alina CUNK PERKLIČ, Përfaqësuese e lartë e Ministrisë Sllovene të Bujqësisë, Pyjeve dhe Ushqimit. Kryetare e Komitetit Koordinues të CLLD/LEADER

Dott. Carlo Ricci, Ekspert i pavaruar

Goran Šoster, Përfaqësues i PREPARE aisbl - Partnership for Rural Europe

Përshkrim i shkurtër dhe Objektivat e sesionit:

Nisur nga fakti se promovimi i zhvillimit rural paraqet një ndër sfidat kryesore për politikën e zhvillimit në Shqipëri, paneli do të synojë të nxisë debatin aktual rreth zhvillimit rural në Shqipëri, duke u fokusuar në shqyrtimin e çështjeve kritike të sektorit. Ky panel ka për qëllim të analizojë me panelistët sfidat kryesore me të cilat përballet zhvillimi rural në Shqipëri. Qasja ndër-sektoriale dhe shumë –aktorëshe aq shumë e nevojshme e zhvillimit rural do të jetë në fokus të diskutimeve. Për më tepër, paneli do të theksojë rëndësinë dhe ndikimin e përfshirjes së aktorëve jo publikë në axhendën e zhvillimit rural në Shqipëri dhe më gjerë në rajon dhe në BE. Përpjekjet e qeverisë për të avancuar axhendën rurale dhe perspektivat e ardhshme në këtë sektor do të reflektohen në panel. Sfidat e kërkimit shkencor në lidhje me politikbërjen dhe zhvillimin rural do të adresohet nga një perspektivë akademike. Diskutime të tilla proaktive do të jenë të rëndësishme për të vendosur kontekstin për sesionet e planifikuara në vijimësinë e PRSH. Prezantimet e panelit do të synojnë që të ngrenë debatin mbi zhvillimin rural duke adresuar çështjet e mëposhtme:

- ▶ Cilat janë prespektivat e debatit aktual mbi zhvillimin rural?
- ▶ Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballet bujqësia shqiptare dhe zhvillimi rural në kontekstin e përafrimit me politikën e BE-së?
- ▶ Cilat janë sfidat kryesore të kërkimit shkencor në lidhje me politikbërjen dhe zhvillimin rural?
- ▶ Cila është perspektiva e donatorëve lidhur me sfidat dhe çështjet e zhvillimit rural?
- ▶ Cili është roli i shoqërisë civile në debatin aktual të zhvillimit rural në Shqipëri? Deri në çfarë mase mund të kontribuojë qasja advokuese nga poshtë-lart?
- ▶ Cilat janë sfidat kryesore të politikave të zhvillimit rural dhe zbatimi efektiv i tyre në Shqipëri? A i përgjigjen politikën e zhvillimit rural sfidave dhe çështjeve kyçe në zhvillimin rural?
- ▶ Cila është strategjia e qeverisë për përsheptimin e axhendës kombëtare rurale në lidhje me qasjen LEADER/CLLD? A ka ndonjë hap aktual për të përgatitur shoqërinë dhe për të ndërtuar kapacitetet e saj për të absorbuar instrumentet financiare të BE-së?
- ▶ Cilat janë mësimet e nxjerra nga vendet e reja të BE? - Rasti slloven në lidhje me zbatimin e LEADER. Çfarë mund të mësojmë nga eksperiencat sllovene në zbatimin e qasjes Leader?
- ▶ Pse LEADER / CLLD duhet të njihet si një qasje e fuqishme zhvillimi?

Prezantimet do të ofrojnë një qasje aktuale të temave në panel, duke ofruar mundësinë e shqyrtimit të alternativave të tjera apo çështjeve në zhvillim.

Pyetje dhe diskutime

12.30 PUSHIM DREKE

14.00 WORKSHOPE simultane TEMATIKE–Qasja shumëaktorëshe dhe ndërsektoriale e zhvillimit rural


Godina B, Kati 3-të

Përshkrim i shkurtër dhe Objektivat


Këto workshope do të theksojnë rëndësinë e qasjes shumë-aktorëshe në zhvillimin rural, duke nxitur debatin lidhur me rolin kryesor që çdo agjent politik, social dhe ekonomik ka në adresimin e sfidave kryesore drejt zhvillimit të qëndrueshëm rural. Pjesëmarrësit në secilin prej workshopeve tematike do të diskutojnë dhe thellojnë njohuritë mbi potencialet, kapacitetet dhe vështirësitë që secili prej aktorëve përballet për të artikuluar qartë dhe për të kryer rolin e vet në fushën e zhvillimit rural. Diskutimet do të jenë konstruktive dhe pozitive duke u përpjekur t'i kthejnë sfidat e identifikuara në mundësi për veprime të ardhshme. Pjesëmarrësit që përfaqësojnë aktorë të ndryshëm të sektorit rural do të punojnë së bashku (me mirëkuptimin e ndërsjellë për të arritur objektivin) në një proces të përbashkët të të mësuarit për të rritur llogaridhënien për rolin që duhet të luajnë në lidhje me përafrimin e modeleve pozitive dhe të qëndrueshme të zhvillimit rural për komunitetet rurale.

Workshopet do të fokusohen në çështjet si më poshtë:

1. Zinxhirët e vlerës për zhvillimin rural në territoret lokale shqiptare
2. Roli i akademisë dhe institucioneve kërkimore në zhvillimin e politikave rurale bazuar në evidence
3. Roli i shoqërisë civile në zhvillimin rural dhe përfshirjen sociale të komuniteteve rurale
4. Fermat familjare: alternativa për një jetesë rurale të qëndrueshme dhe zhvillim më të barabartë
5. Diversifikimi i ekonomisë lokale (sipërmarrjet rurale, agroturizëm, slow-food etj – sfidat dhe mundësitë)
6. Zhvillimi lokal me pjesëmarrje, endogjen dhe me qasje nga poshtë-lart



Workshop Tematik 1 Zinxhirët e vlerës për zhvillimin rural në territoret lokale shqiptare	Workshop Tematik 2 Roli i akademisë dhe institucioneve kërkimore në zhvillimin e politikave rurale bazuar në evidence	Workshop Tematik 3 Roli i shoqërisë civile në zhvillimin rural dhe përfshirjen sociale të komuniteteve rurale
(Salla: 304B)	(Salla: 305B)	(Salla: 306B)
Workshop Tematik 4 Fermat familjare: alternativa për një jetesë rurale të qëndrueshme dhe zhvillim më të barabartë	Workshop Tematik 5 Diversifikimi i ekonomisë lokale (sipërmarrjet rurale, agroturizëm, slow- food etj – sfidat dhe mundësitë)	Workshop Tematik 6 Zhvillimi lokal me pjesëmarrje, endogjen dhe me qasje nga poshtë-lart
(Salla: 307B)	(Salla: 308B)	(Salla: 309B)



Workshop Tematik 1

Zinxhirët e vlerës për zhvillimin rural në territoret lokale shqiptare

(Salla: 304B)

Panelistë:

Drini Imami, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Përfaqësues i Lartë i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Alban Zusi, Ekspert, Qendra e Eksporteve Shqiptare

Josif Gorea, Sipërmarrës

Vaip Salkurti, Agro përpunues

Moderator: Remzi Keco, Universiteti Bujqësor i Tiranës UBT

Raportues: Shpresim Domi, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Profil i shkurtër:

Prof. Assoc. Remzi Keco është pedagog në Departamentin e Menaxhimit të Agrobiznesit, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Fokusi kryesor i punës së tij është fusha e menaxhimit të agrobiznesit dhe menaxhimit të sektorit publik. Remziu vjen me një përvojë të suksesshme si menaxher i përgjithshëm në sektorin privat dhe si konsulent në disa kompani të mirënjohura.

Prof. Assoc. Dr. Drini Imami është lektor në Fakultetin Ekonomisë dhe Agrobiznesit, në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Drini ka punuar si konsulent për disa institucione të mirënjohura si FAO, SNV, Banka Botërore, GIZ dhe projekte të BE etj. Ai ka kryer hulumtime në disa institucione kërkimore evropiane dhe ka kontribuar në rreth 30 raporte teknike dhe 50 botime shkencore.

Hyrje

Përmirësimi i koordinimit të zinxhirit të vlerave është i rëndësishëm për të përmirësuar efikasitetin dhe standardet, veçanërisht në rastin e eksporteve në BE. Përmirësimi i koordinimit kërkon mbështetje të mirë-hartuara që nënkupton krijimin e politikave të bazuara në evidencë duke përfshirë konsultime intensive sikurse ofrohen në këtë workshop.

Qëllimi i workshopit:

Të diskutoj format aktuale të koordinimit të zinxhirit të vlerave në sektorin agro-ushqimor (duke përfshirë koordinimin vertikal si bujqësia kontraktuale dhe bashkëpunimin horizontal), sfidat dhe nevojat për mbështetje. Paneli do të trajtojë pyetjet e mëposhtme:

- ▶ Cilat janë format aktuale të koordinimit horizontal dhe vertikal në zinxhirin e vlerave të sektorit agro-ushqimor?
- ▶ Pse ka nevojë për përmirësimin e bashkëpunimit horizontal?
- ▶ Pse ka nevojë për përmirësimin e koordinimit vertikal?
- ▶ Cilat janë skemat mbështetëse të nevojshme dhe të zbatueshme për të nxitur bashkëpunimin horizontal dhe koordinimin vertikal (psh. bujqësia kontraktuale)?

Workshop Tematik 2

Roli i akademisë dhe institucioneve kërkimore në zhvillimin e politikave rurale bazuar në evidence

(Salla: 305B)

Panelistë:

Engjell Skreli, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Përfaqësues i Lartë i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike

Geron Kamberi, Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit

Flamur Thaçi, Nën/Kryetar, Bashkia Has

Moderator: Rezart Postoli, UBT

Raportues: Amalia Tola, UBT

Profil i shkurtër:

Prof. Dr. Engjell Skreli është profesor në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Ai ka fituar diplomën 'doktor', në vitin 1999, nga Universiteti Bujqësor të Tiranës në fushën e veprimit kolektiv, dhe diplomën 'Master of Science' nga Instituti Mesdhetar i Montpellier (France) në fushën e zhvillimit rural, në vitin 1994. Engjell është lektor në lëndët e Politikave të bujqësisë dhe Ushqimit, Analizës së Politikave të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Metodologjisë së kërkimit në Ekonominë e Zbatuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Prof. Skreli ka dhënë një kontribut të shquar shkencor në fushat e veprimit kolektiv, integritimit vertikal të aktorëve të zinxhirët e vlerës në bujqësi dhe analizën e preferencave të konsumatorëve, të provuar me një numër të konsiderueshëm artikujsh shkencor dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare. Ai ka një eksperiencë të gjerë si konsulent, duke punuar për një numër agjensish si PNUD, FAO, SNV, GIZ, etc.

Prof. Dr. Rezart Postoli është pedagog në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, në Departamentin e Lëndëve Klinike. Rezarti ka drejtuar disa projekte kërkimore duke gjetur në këtë mënyrë zgjidhje afat-shkurtra dhe afat-gjata për të mbuluar nevojat që ka kërkimi për pajisje bashkëkohore. Ai është angazhuar vazhdimisht si drejtues shkencor dhe anëtar në disa ekipe shkencore në kuadër të programeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Ai është një studiues i profilizuar dhe ka botuar dhe referuar në mjaft konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Cilësia e këtyre botimeve dhe referimeve është e lartë si dëshmi e mëtejshme e ndikimit të punës së tij. Prof. Postoli ka përvojë shumë të gjatë bashkëpunimi me disa Universitete në Europë në kuadër të Programeve të ndryshme.

Hyrje

Kërkimi shkencor ka ende nevojë të zhvillojë potencialet dhe infrastrukturën e tij kërkimore, në funksion të politikave cilësore të zhvillimit rural dhe bujqësor dhe të informuar nga evidencat. Gjithashtu, politikëbërësit, vendimmarrësit apo institucionet e tjera publike dhe private në fushën e zhvillimit rural kanë nevojë të nxisin kapacitetet e tyre në përdorimin e kërkimit shkencor që çojnë drejt praktikave të bazuara në fakte të konsoliduara. Në fokus të workshopit do të jenë adresimi i çështjeve të ofertës dhe kërkesës për kërkim dhe lidhjes të të dyjave, duke patur në vëmendje dhe çështje të organizimit institucional të institucioneve kërkimore dhe të tjera.

Qëllimi i workshopit:

Të ofrojë një pamje të përgjithshme të situatës aktuale të kërkimit dhe se si ai kontribuon në zhvillimin e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural, duke analizuar faktorët e ofertës e kërkimit, kërkesës për kërkim dhe faktorët përkatës institucional.

- ▶ A ka kërkimit në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural sot? Legjislacioni, Doktorata, artikuj, projekte. A është ai i lidhur sa duhet me nevojat e bujqësisë dhe zhvillimit rural?
- ▶ A ka financim publik për kërkimin bujqësor e rural? Buxheti i qeverisë, buxheti i Universitetit
- ▶ Cilat janë institucionet që mund të kenë nevojë për produktet e kërkimit të UBT-së
- ▶ A ka kërkesë nga institucionet publike e sektori privat. A planifikojnë dhe a duhet të planifikojnë fondeve për kërkim
- ▶ Cilat mund të ishin disa çështje kërkimi: Prioritete të zhvillimit rajonal, prioritete të zhvillimit lokal, veprimi kolektiv, integrimi mes aktorëve në zinxhirin e vlerës, inovacioni në bujqësi, eficaenca e fermave, zhvillimi i qëndrueshëm rural (ekonomik, social e mjedisor
- ▶ A ka lidhje mes kërkesës e ofertës? Projekti AHEED, memorandumet. Nëse mungon, eksplorimi i shkaqeve
- ▶ Çështje të organizimit institucional: AKTI, UBT, ofrues të tjerë shërbimesh
- ▶ Menaxhimi publik i ri dhe prodhimi i produkteve publike – menaxhimi publik i centralizuar vs menaxhimit me kontratë

Workshop Tematik3

Roli i shoqërisë civile në zhvillimin rural dhe përfshirjen sociale të komuniteteve rurale

(Salla: 306B)

Panelistë:

Etleva Dashi, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Erisa Cela, përfaqësuese UN Women

Andi Kananaj, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

Matej Stepec, Rrjeti për Zhvillimin Rural, Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ushqimit, Slloveni

Majlinda Hoxha, Agritra Vision, Dibër

Elma Tershana, Nisma “Zëri i të Rinjve”

Moderator: Tatjana Dishnica, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Raportues: Gentian Mehmeti, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Profil i shkurtër:

Prof. Dr. Tatjana Dishnica ka një ekspertizë të gjatë dhe të konsoliduar në zhvillimin rural, përfshirë pozicione të tilla si : Drejtore e Departamentit të Bujqësisë, Komiteti i Shkencës dhe Teknologjisë në Shqipëri; Drejtore e Institutit Kombëtar të Kërkimeve të Tokës; Drejtore e Kërkimit Bujqësor në Ministrinë e Bujqësisë (1995-2013). Zj. Dishnica është anëtare e Komitetit Këshillimor Shkencor të CIHEAM (2013-2017). Ajo ka qenë Koordinatore Kombëtare e pesë Projekteve, të themeluar nga FAO dhe gjithashtu disa projekte të tjera të financuara nga qeveria Hollandeze, Bashkëpunimi Italian, SNV, MADA, etj. Ekspertiza e saj kryesore përqëndrohet në hulumtimin bujqësor dhe shërbimin e ekstensionit, bashkëpunimin bujqësor, ndryshimin e klimës, etj. Aktualisht Prof. Dishnica është lektore e lëndve (Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës dhe ujit, prodhimi i grurit dhe edukimi mjedisor) në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Ajo është gjithashtu Drejtore Ekzekutive e një organizate lokale, "Gratë në Bujqësi të Qëndrueshme".

Elteva Dashi aktualisht punon si lektore e Zhvillimit të Qëndrueshëm Rural në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Ajo ka më shumë se pesëmbëdhjetë vite e përfshirë në aktivitete të ndryshme dhe studime kërkimore në sektorë të ndryshëm të ekonomisë duke përfshirë fushat e zhvillimit rural, ekonominë mjedisore dhe zhvillimin rajonal. E diplomuar në ekonomi bujqësore dhe e specializuar në bujqësi të qëndrueshme, ajo ka treguar kompetencën e saj në këto fusha jo vetëm si lektore në Universitet, por edhe si studiuese.

Etleva ka punuar në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar si eksperte kryesore për disa organizata kombëtare dhe ndërkombëtare si FAO, USAID, GIZ, IDM, VIS Albania etj. Gjithashtu ajo ka qënë pjesë e ekspertëve të grupit për të ndihmuar projektet e simulimeve LAG-LEADER në Shqipëri .

Hyrje:

Ndonëse shoqëria civile në Shqipëri ka demonstruar një rol të besueshëm dhe dinamik në përfaqësimin e zërave të banorëve të varfër, ajo ska qënë mjaftueshëm aktive në sjelljen e ndryshimeve transformuese në jetën e komuniteteve rurale. Në zonat e thella dhe rurale shoqëria civile është e përfaqësuar dobët dhe shumë e fragmentuar, me rreth 89% të OSHC-ve me qendër në Tiranë dhe qytete të tjera kryesore të vendit dhe vetëm 11% që veprojnë në zonat rurale. Transformimi social dhe ekonomik që ka ndodhur gjatë procesit të tranzicionit në Shqipëri ka ndikuar në zonat rurale dhe ka reflektuar veçanërisht në statusin e komuniteteve më vulnerable, të tilla si të rinjtë dhe gratë, duke i pozicionuar ata në kufijtë e marginalizimit social dhe ekonomik. Produktiviteti i grave në bujqësi dhe aktivitete të tjera në zonat rurale është shumë i varur nga mundësia e tyre për qasje në informacion dhe shërbime ekstensionit. Duke pasur parasysh kontributin e e mirënjohur të grave në bujqësi, fokusin aktual gjinor në zhvillimin rural, politikat dhe programet bujqësore konsiderohen kryesisht të pamjaftueshme. Ndërkohë, OSHC-të rurale duhet të harmonizojnë objektivat e tyre në zbatimin e projekteve që adresojnë më efektivisht nevojat e grupeve më vulnerabël dhe të marginalizuara si gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara ose emigrantët e kthyer dhe azilkërkuesit në këto fusha. Ky panel do të adresojë çështjet dhe rekomandimet kryesore për OSHC-të rurale për të adresuar më mirë përfshirjen sociale të grupeve të vulnerabël.

Qëllimi i workshopit:

Të identifikojë dhe të nxjerrë në pah rolin, nevojat dhe perspektivat e rëndësishme që OShC-të rurale luajnë në përfshirjen sociale të kategorive vulnerabël me një vëmendje të veçantë gratë dhe të rinjtë. Të eksplorojë mundësitë e OSHC-ve rurale për rrjetëzimin, ndarjen e përvojave dhe pikëpamjeve në lidhje me procesin e mobilizimit të përpjekjet e tyre në adresimin e nevojave të komuniteteve të marginalizuara në zonat rurale. Paneli do të trajtojë çështjet e mëposhtme:

- ▶ Cila është gjendja aktuale e sektorit të OShC-ve në zonat rurale dhe të thella (hatëzimi i zonave gjeografike, fushat tematike të punës) dhe cili është kontributi i tyre specifik në shërbimet që synojnë komunitetet e marginalizuara rurale? Cilat potenciale mund të shfrytëzohen në këtë drejtim?

- ▶ Cilat janë nismat aktuale komunitare të udhëhequra në lidhje me kohezionin social dhe qasjen e komuniteteve të margjinalizuara në shërbimet dhe të drejtat themelore? Drejtimi për përfshirjen sociale të banorëve lokal në komunitetet rurale?
- ▶ Cilat janë lidhjet dhe format ekzistuese të partneritetit midis OShC-ve, bizneseve dhe institucioneve vendore? Si t'i konsolidohen këto përpjekje?
- ▶ Cilat janë sfidat, mjetet, rolet dhe përgjegjësitë aktuale të OShC-ve rurale që duhet të priorizohen me qëllim përfshirjen e formave të Partneritetit LEADER / LAG?

Workshop Tematik 4

Ferme familjare: alternativa për një jetesë rurale të qëndrueshme dhe zhvillim më të barabartë

(Salla: 307B)

Panelistë:

Fatmir Guri, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Berthold Wohlleber, Këshilltar i lartë, projekti GIZ-SARED (tbc)

Arben Kipi, përfaqësues FAO

Tomi Pikuli, AgriNET

Viktor Malutaj, AgroPuka

Moderator: Prof.Dr. Bahri Musabelliu, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Raportues: Orion Xhoxhi, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Hyrje:

Sektori i bujqësisë në Shqipëri penalizohet nga disa karakteristika strukturore (të tilla si shkalla e vogël e prodhimit, përdorimi i kufizuar i inputeve, etj.) të cilat reflektohen në produktivitetin e kufizuar të tokës dhe punës në zonat rurale. Analiza e fermave bujqësore në tri rajone përfaqësuese të vendit tregon se llojet kryesore të fermave ekzistuese në vend janë: "Poli-kultura kryesisht për treg", "Ferme të kohës së lirë", "Prodhimet e kultivuara", "Pemët frutore" "Të pavarura" dhe 'Specializimi i Blegtorisë'. Migracioni rural në zonat urbane do të vazhdojë të jetë fenomen shoqëror i Shqipërisë në të ardhmen. Madhësia e fermës do të varet kryesisht nga kapaciteti i zonave urbane për të absorbuar popullsinë e re që vjen nga zonat rurale. Familjet me fermë "Prodhimet e kultivuara" kanë një probabilitet më të lartë për të migruar në të ardhmen. Kjo lloj ferme karakterizohet nga një pjesë e rëndësishme e të ardhurave jo-bujqësore dhe produktivitetit të kufizuar të AWU. Llojet e tjera të fermave që kanë karakteristika të ngjashme (p.sh. ferme të kohës së lirë dhe pemët frutore) kanë një rezistencë më të lartë ndaj migrimit për shkak të moshës së fuqisë puntore ose strukturës së investimeve. Struktura e të ardhurave të të gjitha llojeve të fermave bazohet në një kombinim të të ardhurave bujqësore dhe jobujqësore. Pa këtë kombinim pothuajse 31% e fermave të anketuara që kultivojnë 34% të zonave bujqësore vështirë se mund të arrijnë nivelin e pragut të të ardhurave të varfërisë ekstreme për anëtarët e familjes së tyre. Llojet më produktive të fermave (prodhimi i tokës dhe AUW) kanë një nivel më të ulët të të ardhurave totale për anëtarët e familjes dhe ato më pak produktive kanë një nivel më të lartë të të ardhurave nga anëtarët e familjes për shkak të një pjese të

rëndësishme të të ardhurave jo bujqësore. Të ardhurat mesatare gjithsej nga anëtarët e familjes tejkalojnë ndjeshëm varfërinë ekstreme dhe pragun e varfërisë së plotë. Këto konkluzione janë në përputhje me studimet e bëra së fundmi nga Instituti i Statistikave në Shqipëri, që tregojnë se zonat rurale kanë një elasticitet më të lartë se zonat urbane dhe rezistojnë më mirë ndaj faktorëve riskues të jashtëm krahasuar me zonat urbane (INSTAT 2013). Është utopike të besohet se një mbështetje e përshtatur për bujqësinë në zonat rurale do të përmirësojë ndjeshëm kushtet ekonomike dhe do të ulë nivelin e varfërisë në zonat rurale. Politikëbërësit duhet të marrin në konsideratë një politikë që synon objektivat: a) rritja e produktivitetit të fermave (për fermerët bazuar në të ardhurat bujqësore) dhe b) diversifikimi ekonomik në zonat rurale (për fermerët bazuar në të ardhurat jo bujqësore). Strategjia e ndjekur nga qeveria shqiptare për të mbështetur kryesisht produktivitetin bujqësor dhe në një masë më të vogël zhvillimin rural (MBUMK 2007 (b)) mund të riprodhojë një migrim tjetër nga zonat rurale në zonat urbane dhe të rrisë shkallën e papunësisë në zonat urbane. Rasti i Shqipërisë tregon se politikëbërësit duhet të jenë të vetëdijshëm se zonat rurale nuk t'i përkushtohen ekskluzivisht gjenerimit të të ardhurave nëpërmjet bujqësisë, por edhe aktiviteteve më të diversifikuara ekonomike. Fermerët tashmë janë të vetëdijshëm për këtë.

Qëllimi i workshopit:

Të analizojë karakteristikat kryesore të sistemeve të fermave në Shqipëri, tipologjinë, rolin e tyre aktual dhe potencial në mirëqënien e familjeve. Paneli do të trajtojë çështjet e mëposhtme:

- ▶ Analiza e sistemeve të fermave në Shqipëri
- ▶ Struktura dhe tipologjia e fermave në Shqipëri
- ▶ Analiza e qëndrueshmërisë së fermave
- ▶ Performanca ekonomike e fermave
- ▶ Rekomandime për politikat për rritjen e produktivitetit të fermave dhe diversifikimin ekonomik në zonat rurale

Workshop Tematik 5

Diversifikimi i ekonomisë lokale (sipërmarrjet rurale, agroturizëm, slow-food etj – sfidat dhe mundësitë)

(Salla: 308B)

Panelistë:

Edvin Zhllima, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Enea Hoti, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Ardit Collaku, Agjencia Kombëtare e Turizmit

Pier Paolo Ambrosi, Lëvizja Slow food

Jonel Kristo, Fondi për Investimet në Turizëm në Shqipëri

Petrit Dobi, Programi për Mbështetjen e Shoqatave Rurale

Moderator: Natasha Hodaj, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Raportues: Ledia Thoma, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Profil i shkurtër:

Prof.Dr. Natasha Hodaj aktualisht është Shefe e Departamentit të Politikave të Ekonomisë dhe Zhvillimit Rural në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Znj. Natasha punon si Pedagoge e Ekonomisë Mjedisore dhe Burimeve Natyrore në Universitetin Bujqësor të Tiranës, prej më shumë se 30 vitesh. Ajo ka një eksperiencë të konsoliduar në adresimin e çështjeve socio-ekonomike të ristrukturimit të fermave, si punësimi rural, gjenerimi i të ardhurave alternative, çështjet sociale, shpërndarja e inputeve, shërbimet e konsumatorit dhe shoqatat e fermerëve. Ajo ka drejtuar disa projekte dhe programe në fushat e Menaxhimit të Agrobiznesit; Bashkëpunimi dhe Integrimi në Bujqësi; Planifikimi në bujqësi; Menaxhimi Strategjik në Bujqësi. Ndërkohë ajo është eksperte e Këshillit të Europës për kohezioni social: punësimin, politikat sociale, migracionin, nënshtetëzinë dhe minoritetet.

Prof. Assoc. Dr. Edvin Zhllima ka përfunduar Masterin Shkencor në Ekonomi Europiane në Universitetin e Tiranës, Masterin e Arteve në Ekonomi Ndërkombëtare dhe Zhvillimore në Universitetin e Shkencave të Aplikuara, Berlin dhe Doktoraturën në Ekonomi dhe Politika Agroushqimore në Universitetin e Bolonjës. Edvini është pedagog i Makroekonomisë, Ekonomisë Institucionale dhe Ekonomisë së Zhvillimit në Fakultetin Ekonomisë dhe Agrobiznesit, në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Edvini ka punuar si ekspert në agrobiznes dhe zhvillim rural për projekte të financuara nga UNDP, FAO, IFAD, SNV, USAID, WV, MADA etj.

Hyrje:

Shqipëria është një vend në zhvillim me një ekonomi të përqëndruar kryesisht në aktivitetet bujqësore. Tranzicioni solli ndryshime të shumta socio-ekonomike, por ende pothuajse gjysma e popullsisë është rurale dhe rreth 40 përqind e fuqisë punëtore të vendit është e angazhuar në bujqësi - kryesisht të vetëpunësuar në fermat e vogla, gjysmë-të subvencionuara. Megjithatë, aktivitetet e fermave nuk janë të mjaftueshme për të punësuar familjet rurale dhe për të mundësuar angazhimin e fuqisë punëtore, dhe për rrjedhojë papunësia mbetet ende një sfidë e madhe. Koncepti i diversifikimit ekonomik merr parasysh madhësinë, praninë e specializimeve të shumta dhe lidhjet ndërmjet sektorëve dhe industrive brenda ekonomisë së një rajoni për të zhvilluar potencialin për rritje si dhe për t'i rezistuar më mirë ndryshimeve të ardhshme strukturore ose krizave ekonomike. Madhësia e vogël e tregut lokal, qasja e ulët në punë të kualifikuar, strukturat e fragmentuara të firmave, të cilat kanë shpërndarje të rrallë dhe me një largësi të konsiderueshme, si dhe pengesat për shërbimet e biznesit janë sfidat kryesore për diversifikimin ekonomik.

Qëllimi i workshopit:

Identifikimi i diversitetit rural në Shqipëri: adresimi i sfidave dhe mundësive për diversifikimin e ekonomisë rurale si një nga hallkat kyçe për mirëqënien në zonat rurale dhe nxitjen e qëndrueshme të ekonomisë lokale. Paneli do të trajtojë çështjet e mëposhtme:

- ▶ Të vlerësojë rëndësinë e diversifikimit rural në zonat rurale dhe të shqyrtojë zinxhirët kryesorë të vlerave në gjenerimin e të ardhurave dhe punësim
- ▶ Kontributi i diversifikimit rural në ekonominë informale, barazinë gjinore, menaxhimin e burimeve natyrore dhe në përgjithësi në jetesën rurale
- ▶ Identifikimi i potencialeve kryesore për diversifikimin e ekonomisë rurale dhe sfidat kryesore për promovimin e diversifikimit në mënyrë që të adresohet pjesëmarrja e ulët e fuqisë punëtore dhe pabarazitë.
- ▶ Mësimet e nxjerra nga praktikat më të mira në Shqipërinë rurale (në të vërtetë nuk ka të dhëna të regjistrave për modelet e biznesit) për formulimin e strategjive të rëndësishme vendore dhe mekanizmat inovativ për diversifikimin e ekonomisë rurale

Workshop Tematik 6

Zhvillimi lokal me pjesëmarrje, endogjen dhe me qasje nga poshtë-lart

(Salla: 309B)

Panelistë:

Sotiraq Hroni, Kryetar Bordi, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural
Roland Bardhi, Projekt menaxher, MADA (Agjencia për Zhvillimin e
Zonave Malore)

Shefqet Bruka, Ekspert i Lartë, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
Mirjeta Gjongecaj, LAG Bjeshkët e Nëmuna

Anila Boshnjaku, Përfaqësuese e WWF Adria në Shqipëri

Moderator: Jetona Myteveli

Raportues: Rozeta Mihali

Profil i shkurtër:

Jetona Myteveli ka punuar për shumë vite në fusha të ndryshme të zhvillimit të integruar lokal në Shqipëri. Si e tillë, ajo ka një eksperiencë të gjerë dhe të konsoliduar në zhvillimin lokal dhe rajonal. Jetona ka qenë e angazhaur në menaxhimin e disa programeve të rëndësishme të zhvillimit rural. E jashtëzakonshme është përvoja e saj në asistimin e krijimit dhe konsolidimit të Grupeve Lokale te veprimit sipas qasjes LEADER.

Jetona ka punuar si eksperte për forcimin e kapaciteteve të qeverisjes rajonale dhe lokale dhe institucioneve jo-qeveritare, elaborimin e strategjive të zhvillimit rajonal ndërsektorial si dhe ofrimin e programeve të ngritjes së kapaciteteve në fusha të ndryshme relevante me zhvillimin lokal të udhëhequr nga komuniteti.

Z. Sotiraq Hroni është Kryetar Bordi dhe themelues i Rrjetit Shqiptar për Zhvillim Rural (ANRD) - rrjet i njëzet e dy organizatave të shoqërisë civile themeluar në fund të vitit 2015. Krijimi i Rrjetit ka qenë kurorëzim i përpjekjeve advokuese dhjetëvjeçare me qasje nga poshtë-lart.

Anëtar i komitetit organizues PREPARE – organizatë europiane që punon për fuqizimin e shoqërisë civile në zhvillimin rural. Anëtar i Komitetit të Monitorimit të IPARD II në Shqipëri.

Z. Hroni është ish-diplomat dhe këshilltar i Kryeministrit dhe Presidentit të Shqipërisë. Ai ka një përvojë të pasur angazhimi me shoqërinë civile gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit, veçanërisht në qeverisjen e mirë dhe zhvillimin e integruar lokal, pjesëmarrjen qytetare dhe hartimin e politikave të bazuara në evidencë.

Gjithashtu, z. Hroni është Drejtor Ekzekutiv i Insitutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim.

Hyrje

Grupet Lokale të Veprimit (GLV) janë struktura partneritete tri-palëshe ndërmjet sektorit publik – privat – shoqërisë civile dhe përfaqësojnë një tipar origjinal dhe të rëndësishëm të qasjes LEADER. GLV-ja ka për detyrë të identifikojë dhe zbatojë strategjinë e zhvillimit lokal, të marrë vendime për ndarjen e burimeve financiare dhe menaxhimin e tyre.

Në Shqipëri, që nga viti 2009, organizata të ndryshme si SNV, MADA, Oxfam, GIZ kanë zbatuar iniciativa që kanë për qëllim krijimin dhe forcimin e kapaciteteve të Grupeve Lokale të Veprimit.

Ky ëorkshop synon të ofrojë një platformë reflektimi dhe ndarjeje përvojë nga profesionistë aktivë ndërkombëtarë dhe kombëtarë dhe udhëheqës të Grupeve lokale të veprimit ekzistuese në Shqipëri, si dhe diskutime interaktive midis pjesëmarrësve.

Panelistët do të sjellin reflektimet e veta rreth procesit të formimit të GLV-së në Shqipëri, do të ndajnë faktorët e suksesit dhe sfidat lidhur me mobilizimin e aktorëve relevantë dhe qasjen nga poshtë lart, ndërtimin e besimit dhe kapaciteteve, zgjedhjen e strukturës së duhur ligjore dhe regjistrimin dhe sigurimin e një strukturë të qëndrueshme që në mënyrë efektive adreson çështjen e zhvillimit rural. Pjesëmarrësit do të diskutojnë dhe do të artikulojnë hapat konkretë në rrugën përpara drejt qasjes LEADER-CLLD të BE-së në Shqipëri, praktikat më të mira që duhen marrë në konsideratë dhe njohuritë për trajtimin e sfidave dhe sigurimin e GLV-ve efektive.

Qëllimi i workshopit:

Të krijoj një tablo të përgjithshme të zbatimit të qasjes LEADER/l LAG në Shqipëri në kuadër të iniciativave të mëparshme si dhe të analizojë faktorët pengues apo potencial në qasjen pjesëmarrëse nga poshtë-lart

Pyetjet e mëposhtme do të adresohen në panel:

1. Cilat është panorama në lidhje me përvojat e mëparshme të tipit LEADER/LAG në Shqipëri? Statusi aktual?
2. Cilat janë sfidat aktuale të zbatimit të qasjes LEADER? Legjislacioni, Krijimi i sinergjive? Ngritja e kapaciteteve të aktorëve lokal?
3. Pozicionimi i tre sektorëve në lidhje me angazhimin e tyre në krijimin e partneriteteve trepalëshe në nivel lokal?
4. Hapat konkretë dhe qëndrueshmeria e strukturës për të adresuar çështjet e zhvillimit rural në Shqipëri?
5. Si ndihmojnë LAG-et /LEADER në zhvillimin ekonomik të zonave rurale dhe fuqizimin e demokracisë pjesëmarrëse ?

16:00- Transferimi i njohurive dhe shkëmbimi i eksperiencavemi
17:30 Grupet Lokale të Veprimit LEADER LAG - rrugëtimi drejt zbatimit të qasjes LEADER në Shqipëri

(Raundi 1)

6 Workshope simultane me ekspertë ndërkombëtar LEADER dhe Menaxherë të Grupeve Lokale të Veprimit (LAG) / (Pjesëmarrësit do të ekspozohen me praktikat më të mira nga Italia, Kroacia, Serbia, Sllovenia dhe Gjermania)

Godina B, Kati 3-të

19:00 Darka dhe RRJETËZIM

Përshkrim i shkurtër dhe Objektivat:

PRSH është ideuar (dizenjuar) si një platformë shkëmbimi i eksperiencave dhe praktikave për nxitur politikëbërjen dhe përmirësimin e praktikave aktuale drejt zhvillimit të qëndrueshëm rural. Pjesëmarrësit do të ekspozohen ndaj LAG-ve (Grupe Lokale Veprimit) me tematika të ndryshme zhvillimi në rajon dhe në BE. LEADER nuk ka të bëjë vetëm me shkëmbimin, bashkëpunimin dhe partneritin brenda çdo zone vendore, por përfshin në një kontekst më të gjerë dhe një bashkëpunim të frytshëm midis aktorëve të tjerë rajonalë, me qëllim të shkëmbimit të perspektivave në transferimin e njohurive në lidhje me LAG-et.

Është e rëndësishme të theksohet se një ndër qëllimet kryesore të panelit është ndërtimi i kapaciteteve dhe thellimi i njohurive të aktorëve lokalë në lidhje me zbatimin e qasjes LEADER/CLLD, përmes transferimit të përvojave dhe modeleve pozitive nga vende të tilla si Italia, Kroacia dhe Sllovenia, Serbia, Gjermania.

Studimi i rasteve të LAG-eve dhe mësimet e nxjerra synojnë të transmetojnë te pjesëmarrësit një informacion të thjeshtë dhe të qartë (të absorbueshëm), që reflekton gjithçka mbi LAG-et dhe ndikimin e tyre në jetën e komuniteteve rurale. Ndarja e përvojave do të kontribuojë pozitivisht në rritjen e besimit të aktorëve lokalë për të ndërmarrë iniciativa konkrete në zbatimin e LEADER-it në komunitetet lokale.



Workshop LEADER LAG 1: LAG Posavje, SLLOVENI Moderator: Janja Jordan	Workshop LEADER LAG 2: LAG Srijem, KROACI Moderator: Albert Varga	Workshop LEADER LAG 3: LAG Maiella Verde, ITALI Moderator: Carlo RICCI
(Salla: 304B)	(Salla: 305B)	(Salla: 306B)
Workshop LEADER LAG 4: LAG Prlekija, SLLOVENI Moderator: Goran Soster	Workshop LEADERLAG 5: LAG Izvor, KROACI Moderator: Matija Zamljačanec	Workshop LEADERLAG 6: LAG Deliblatska Peščara LAG 321 Čoka, SERBI Moderators: Ivana Stefanović&Boris Ilic
(Salla: 307B)	(Salla: 308B)	(Salla: 309B)

Workshop LEADER

LAG 1:

LAG Posavje, SLOVENIA

Moderator: Janja

Jordan

(Salla: 304B)

LEADER LAG Workshop 1:

LAG Posavje, SLOVENIA

Jordan Janja është Presidente e Grupit Lokal të Veprimit Posavje për periudhën aktuale 2014-2020. Ajo është diplomuar në Master Shkencor Qeverisja dhe Studimet Europiane. Ajo ka qenë Presidente e Komisionit për Zhvillimin Urban në Shoqatën e Bashkive në Slloveni. Ajo ka punuar për më shumë se 10 vite dhe në vitet e fundit ka qenë Menaxhere Projekti në Komisionin për Rivitalizimin e qytetit Krško, Menaxhere projekti e Projektit të Marketingut të Qytetit në projektin e Fondit Europian të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ajo ka punuar si mbështetëse financiare në implementimin e thirrjeve të Fondeve të BE dhe asistencës teknike në Bordin Supervizues. Zj. Jordan ka qenë nismëtare e projektit të bashkëpunimit LAG të quajtur “Fshatra Inteligjente” dhe ka qenë e përfshirë si kreu i bashkëpunimit për Fondet e BE – eksperte dhe përgjegjëse për projektet e BE-së në Bashkinë Krško.

Projekti: Fshatra Inteligjente (Smar Villages)

Projekti Fshatra Inteligjente implementohet nga katër LAG-e (Grupe Lokale Veprimi): LAG Posavje, LAG Prlekija, LAG Obsotelje në Kozjansko dhe LAG Brkini në Kras. Projekti synon të zhvillojë konceptin e fshatrave inteligjente dhe qasjeve që kontribuojnë në rritjen e cilësisë së jetës dhe zhvillimit ekonomik të zonave rurale.

Fokusi Kryesor: TIK dhe marketing, Zinxhirët ushqimor, shërbimet sociale në zonat rurale, lidhja ndërmjet zonave urbane dhe rurale, turizmi rural.

Qasja kryesore: zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti. Projekti është në fazat e tij të para të zhvillimit. LAG-et synojnë të 1) eksplorojnë praktikën ekzistuese dhe konceptet e lidhura me fshatrat inteligjente në Slloveni dhe më gjerë 2) të analizojë nevojat lokale për zhvillimin e shërbimeve të reja dhe inovative në zonat rurale 3) të zhvillojë koncepte që targetojnë fillimisht përdorimin e teknologjisë digjitale që mbështet zhvillimin ekonomik dhe marketingun (zinxhirët ushqimorë, promovimin e produkteve lokale, ekonominë e përbashkët) dhe lidhjet ndërmjet zonave rurale dhe urbane në fushën e shërbimeve sociale (kujdesi në shtëpi, e-lëvizshmëria), e ndjekur nga 4) trajnime dhe testime pilot në fushën e bashkëpunimit ndërmjet LAG-eve, dhe 5) rrjetëzim, aktivitete për rritje ndërgjegjësimi dhe ndarje informacioni. Njëkohësisht, një strategji për zhvillimin e qëndrueshëm të fshatrave inteligjente duhet të hartohet.

Grupet e synuara: fermerë dhe ofrues të tjerë lokal të produkteve dhe shërbimeve, SME, institucionet publike, të moshuarit dhe grupe të tjera vulnerabël.

LEADER LAG Workshop 2:

LAG Srijem, CROATIA

Albert Varga, ka mbaruar studimet e larta në Universitetin e Splitit, Departamenti i Studimeve Profesionale – Teknologji Informacioni. Që në 2013 që shënon fillimin e zbatimit të qasjes LEADER në Kroaci, Albert Varga ka qenë pjesë e LAG (Grupit Lokal të Veprimit) Srijem. Më parë ai ka punuar si përkthyes librash, programues, administrator webi, dhe ekspert i optimizimit të motorëve të kërkimit, si dhe menaxher i licensimit të muzikës. Si përfaqësues i LAG-ut, Alberti është pjesë dhe shumë aktiv në Rrjetin Kroat për Zhvillimin Rural-HMRR dhe Partneritetit Lokal për Punësim në qarkun Vukovar-Srijem. Gjatë kohës së tij në Grupin Lokal të Veprimit Srijem, ai ka fituar eksperiencë të vlefshme lidhur me qasjen LEADER, si dhe ekspertizë në fushën e zhvillimit rural. Së fundmi, Alberti është zgjedhur President i Rrjetit Kroat për Zhvillimin Rural (HMRR).

**Workshop LEADER
LAG 2:**

LAG Srijem, KROACI
Moderator: Albert Varga

(Salla: 305B)

Local Action Group Srijem

LAG Srijem është themeluar në 2010 si një partneritet ndërsektorial mes sektorit publik, biznesit dhe shoqërisë civile. Në atë kohë LAG Srijem mbulonte 8 bashki dhe 2 qytete. Bashkia Trpinja dhe Bashkia Borovo u bënë pjesë LAG-ut Srijem since 2013. Duke qenë një ndër LAG-et më të suksesshme në Kroaci në zbatimin e qasjes LEADER gjatë periudhës së programimit IPARD, qyteti Vukovar kërkoi të bëhet pjesë e LAG Srijem në 2015. LAG Srijem ndodhet në pjesën më lindore të Kroacisë, në qarkun Vukomar-Syrmia. Aktualisht LAG Srijem mbulon një territor prej 771,48 km² dhe përbëhet nga 3 qytete dhe 10 bashki, me një popullatë prej 43,053. LAG Srijem ka zbatuar qasjen LEADER dhe atë nga ‘poshtë-lart’ që në fillimet e tij në Kroaci dhe ka aplikuar në mënyrë të suksesshme të gjitha thirrjet publike mbi LAG në Kroaci. Aktualisht LAG Srijem numëron 86 anëtarë nga të tre sektorët. Strategjia e Zhvillimit Lokal e LAG Srijem është hartuar gjatë periudhës 2015-2016. Strategjia është adaptuar në qershor 2016 nga Asambelja e LAG-ut. Gjatë procesit të hartimit të Strategjisë janë përcaktuar katër prioritet kryesore: A.1. Fuqizimi i konkurrencës së fermave të vogla bujqësore; A.2. Zhvillimi i produkteve lokale dhe pozicionimi në treg; B.1. Ndërtimi i infrastrukturës publike; B.2. Zhvillimi i shërbimeve bazë.

Workshop LEADER

LAG 3:

LAG Maiella Verde, ITALI
Moderator: Carlo RICCI

(Salla: 306B)

LEADER LAG Workshop 3:

LAG Maiella Verde, ITALI

Dr. Carlo Ricci - agronom, i apasionuar mbi produktet tipike dhe identitetin lokal, Carlo Ricci punon në zhvillimin territorial dhe rural duke ndarë punën e tij midis promovimit dhe koordinimit të projekteve në brendësi të territorit abrucez (si GAL Maiella Verde, Shkolla e Shijes dhe 10 shije për tu shpëtuar) dhe konsulencës si ekspert i pavarur në institucione të nivelit rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Me institucione të nivelit ndërkombëtar, bashkëpunon në cilësinë e ekspertit të vetëm referues për Italinë, për llogari të Contact Point të Rrjetit European të Zhvillimit Rural, për llogari të European Evaluation Help Desk (për DG AGRI) dhe me Njësinë e Mbështetjes të FARNET, Rrjeti European të Zonave Bregdetare të cilat promovojnë strategji të zhvillimit lokal të financuara nga FEAMP, (për DG Mare).

Që nga fillimi i viteve '90, ka krijuar një experience të konsoliduar në projektimin dhe aktualizimin e projekteve të zhvillimit lokal duke marrë pjesë në inisiativa të ndryshme (kryesisht LEADER, por edhe Pakte Territoriale, PIT dhe EQUAL) në rajonet e Abrucos dhe Lacios.

Nga viti 2000, angazhohet gjithashtu në vlerësim e mbështetje në programim si dhe në menaxhimin e politikave të zhvillimit rajonal dhe rural. Në këto fusha, ka punuar me shoqëri, agjensi, Ente Publike dhe Institute Kërkimi në nivel kombëtar (si FORMEZ, INEA, ISFOL, Qarku i Abrucos dhe Studimi i Zhvillimit), ndërkombëtar (si OCSE, Observatori European Leader etj), si dhe ka bashkëpunuar në nisma të ndryshme për llogari të Komisionit European midis të cilave janë vlerësimi ex post i Nismave Komunitare Leader II e Leader + dhe parakushtet e Linjë Guidës mbi vlerësimin e CLLD të publikuara në vitin 2017.

Mbi këto tematika, ka dhënë leksione në kurse dhe master post laurea, ka mbajtur fjalime në seminare dhe takime (edhe me ftesë të Komisionit European) si dhe ka publikuar shkrime.

LAG Maiella Verde mbulon territorin e 81 bashkive në provincën Chieti, e ndarë në tre nënzona: Ortonese Chietino, Sangro Aventino dhe Vastese. LAG-u i themeluar në 1992, është konsorcium me përgjegjësi të kufizuar. Ka një popullatë prej 129,656 banorë dhe mbulon një territor prej 1.944,45 km². LAG-u numëron 126 anëtarë (8 nga sektori publik dhe 118 nga ai privat) duke përfaqësuar komponentët kryesorë institucional, ekonomik dhe social të territorit. LAG Maiella Verde ka qenë aktivisht i përfshirë në periudhat programuese Leader I, Leader II dhe Leader +. Përmes bashkëpunimit territorial, LAG-et synojnë të promovojnë identitetin territorial përmes krijimit të një rrjeti territoresh virtuoze në organizimin e pranimit të filozofisë "slow".

Përmes bashkëpunimit ndërvendor, LAG-u synon të promovojë zhvillimin e turizmit të territoreve lokale. Strategjia e Zhvillimit Lokal synon të përmirësojë cilësinë e ofertës territoriale përmes kualifikimit dhe fuqizimit të vlerës së shtuar të produkteve tipike locale, të peisazhit dhe mjedisit rural, dhe rritjen e aksesit dhe atraksionit të sistemeve territoriale. Komponentët kryesorë të strategjisë janë: a) prezantimi i elementëve tipikë të biodiversitetit në procesin e prodhimit dhe përpunimit; b) Identifikimi dhe zhvillimi i sistemeve të identitetit lokal; c) përmirësimi i shërbimeve në lidhje me përdorimin e tokës.

Workshop LEADER

LAG 4: LAG Prlekija,
SLLOVENI

Moderator: Goran
Soster

(Salla: 307B)

LEADER LAG Workshop 4:

LAG Prlekija, SLOVENIA

z. Goran Soster mban disa pozicione të rëndësishme në organizata të ndryshme që punojnë në nivel evropian, kombëtar dhe lokal. Ai është President i Rrjetit PREPARE (Partneritet për Europën Rurale), një rrjet evropian i organizatave të shoqërisë civile, dhe nënkryetar i Rrjetit Rural Slloven. Ai është gjithashtu Menaxher i LAG Prlekija në Slloveni. Z. Soster është Drejtor i "Agjencisë së Zhvillimit të Prlekijës", (PRA giz / Slloveni). Kontributi i tij në këtë përpjekje lidhet me krijimin e agjencisë lokale dhe rajonale të zhvillimit të Prlekijës si organizatë jofitimprurëse; promovimin e sipërmarrjes, institucionin mbështetës për SME-të, shërbimin këshillues, menaxhimin e projekteve, ndërtimin e zyrave të shërbimit me një ndalese, burimet njerëzore dhe ndërtimin e partneriteteve, planet e zhvillimit, studimet e fizibilitetit, zhvillimin e produkteve të reja turistike, zhvillimin rural, menaxhimin e grupeve lokale të veprimit. Kontributi i tij i mirënjohur thekson ekspertizën e tij si Inicimator i katër Parlamenteve Rurale në Slloveni. Parlamenti i katërt slloven Rural u mbajt pak ditë më parë, më 22 shtator 2017.

zoti Soster është anëtar i bordit të ELARD - Shoqata Evropiane LEADER për Zhvillim Rural dhe anëtar i Grupit Drejtues të Parlamentit Evropian Rural. Ai ka më shumë se 18 vjet në ndërtimin dhe menaxhimin e institucioneve, lehtësimin dhe këshillimin e programeve të zhvillimit rural. Përvoja e tij e konsoliduar përfshin pozicionet si menaxher projekti dhe këshilltar / ekspert i lartë në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare për nismat e zhvillimit rural, botime të ndryshme në bujqësinë organike: studime të fizibilitetit, konsolidimi i rrjeteve rurale, ngritja e grupeve lokale të veprimit.

LAG Prlekija është një grup lokal aksionar i themeluar me nismën e tetë komunave (Apače, Gornja Radgona, Križevci, Ljutomer, Radenci, Razkrižje, Sveti Jurij, Ščavnica dhe Veržej), të cilat janë të vendosura në dy njësi administrative (Gornja Radgona dhe Ljutomer). E gjithë zona e GLV-së Prlekija shtrihet në rajonin e zhvillimit të Pomurjes, që është rajoni më pak i zhvilluar i vendit. Zona e GLV-së Prlekija numëron 38.113 banorë dhe shtrihet në 388.7 km². LAG Prlekija u zgjodh dy herë (në vitin 2012 dhe 2013) si një nga pesë GLV-të më të suksesshme në Slloveni.

LEADER LAG Workshop 5:

LAG Izvor, CROATIA

Matija Zamljačanec

Grupi lokal i veprimit "Izvor" përbëhet nga një komunitet i përgjegjshëm i partnerëve të cilët të kanë për qëllim arritjen një standarti jetësor më cilësor, i cili synohet të arrihet së pari përmes përdorimit racional të burimeve si dhe një zhvillimi të balancuar të të gjithëve anëtarëve të komunitetit, duke respektuar vlerat ekzistuese tradicionale dhe kulturore. LAG "Izvor" është një nga zbatuesit kryesor të LEADER në komunat që janë anëtare të Grupeve Lokale të Veprimit "IZVOR". LEADER është një komponent i ri inovativ i politikave të BE në zhvillimin rural. Shkurtimi i LEADER ka kuptimin (Lidhjet ndërmjet ekonomisë rurale dhe veprimeve zhvillimore). Qasja e LEADER inkurajon të menduarit dhe zgjidhjen e problemeve të zhvillimit nëpërmjet formave të reja të partneritetit dhe kombinimit të aktiviteteve. LEADER u krijon mundësinë palëve të interesuara të punojnë së bashku, për të përgatitur produkte cilësore dhe për të ofruar shërbime që gjenerojnë vlerë të shtuar në zhvillimin e potencialeve vendore. Qëllimet kryesore të zbatimit të parimeve LEADER janë:

1. Frenimi i shpopullimit
2. Aktivizimi i burimeve të reja sipërmarrëse
3. Përmirësimi i cilësisë së jetës

Informacion përgjithshëm rreth Grupit Lokal të Veprimit "Izvor"

Grupit Lokal të Veprimit përbëhet nga 2 qytete dhe 6 komuna. Qytetet Ludbreg dhe Varaždinske Toplice dhe bashkitë Trnovec Bartolovečki, Martijanec, Sveti Đurđ, Veliki Bukovec, Mali Bukovec dhe Rasinja.

Grupi lokal i veprimit "Izvor" ka një shtrirje rreth 453.99 km², me një popullsi prej 36.290 banorësh.

Aktivitetet kryesore të grupit lokal të veprimit "Izvor" janë: a) Shkrimi i projekt propozimeve. Masa IPARD - LAG "Izvor" ka mundësuar dorëzimin e 15 letrave rekomandimi për projekte që arrijnë vlerën deri në 54 milionë kuna. Ka asistuar shoqatat në zonat e LAG-ut "Izvor" në rreth 25 projekt propozime të shkruara dhe të dorëzuara në tendera publik në nivel evropian, kombëtar dhe lokal. Grupi Lokal i Veprimit "Izvor" ka dorëzuar në emër të Bashkive dhe Komunave rreth 27 projekt propozime për tendera të hapur në nivel evropian dhe kombëtar me një vlerë të përgjithshme prej rreth 3 milionë kuna.

Workshop

LEADERLAG 5:

LAG Izvor, KROACI

Moderator: Matija

Zamljačanec

(Salla: 308B)

**Workshop
LEADERLAG 6:**

LAG Deliblatska
Peščara
LAG 321 Čoka, SERBI
Moderators: Ivana
Stefanović&Boris Ilic

(Salla: 309B)

LEADER/LAG Workshop 6:

LAG Deliblatska Peščara, SERBIA

Ivana Stefanović Ivana Stefanović punon në fushën e zhvillimit rural në Serbi që prej vitit 2006. Ajo është një prej anëtareve themeluese të pesë grupeve të para lokale të veprimit (para-LAGe) në Serbi, bazuar në parimet e qasjes LEADER. Përpos kombinimit të punës në terren me edukimin e saj, Ivana ka fituar një eksperiencë të konsoliduar përmes të ekspozuarit dhe përfshirjes në politikat e zhvillimit rural. Ivana është angazhuar gjithashtu në përgatitjen e politikave lokale dhe rajonale dhe më pas në monitorimin dhe zbatimin e tyre në zona të veçanta rurale. Ivana është një prej anëtarëve themeluese të Rrjetit Kombëtar LEADER në Serbi në 2015. Fushat e ekspertizës së saj përfshijnë: politikat e zhvillimit rural; zhvillimi i turizmit rural; diversifikimi i ekonomisë lokale; menaxhimi dhe administrimi i projekteve, prokurimet publike.

LAG Deliblatska Peščara " ndodhet në zonat ranore të Deliblatska, të cilat kanë statusin e Resurseve të Mrojtura Natyrore për shkak të të gjitha karakteristikave të tyre specifike. Numri i vendbanimeve që mbulon LAG është 17 ndërsa i njëjtit vendore të vetqeverisjes është katër.

Prioritetet e LAG-ut janë: a) Rritja e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor dhe pyjor, b) Rritja e cilësisë së jetës në zona të synuara rurale dhe diversifikimi i ekonomisë rurale, c) Rritja e kapaciteteve në qasjen LEADER dhe zhvillimi i aftësive menaxhuese.

Qasja dhe metodologjia LEADER për zhvillimin lokal përmes Grupeve Lokale të Veprimit është aplikuar në territorin e komunës Alibunar që prej vitit 2007, në saj të programit të Sekretariatit Rajonal për Bujqësi, Menaxhim të Ujërave dhe Pylltari. Në vitin 2007, Sekretariati filloi punën për mbështetjen dhe krijimin e pesë LAG-ëve pilot. Alibunar ishte një nga pesë LAG-et të krijuar, dhe që prej asaj kohe LEADER është përdorur si një metodologji zhvillimi. Në 2011 DEU implementoi projektin LIS, përmes të cilit, LAG Deliblatska Peščara krijoi strategjinë dhe strukturën e menaxhimit në përputhje me rregullat e mirëpërcaktuara.

Strategjia e zhvillimit lokal u hartua si rezultat i nxitjeve të projektit LIS dhe aktiviteteve të vazhdueshme pesëvjeçare të aktorëve kryesor, të cilët tani formojnë LAG-un Deliblatska. Që prej asaj kohe janë zbatuar më shumë se 25 projekte në total. Përdorimi i metodologjisë LEADER vazhdon ende të përdoret nga aktorët e përfshirë si një nga qasjet kryesore për zhvillimin e fshatrave. Para LAG-et në Serbi ende janë në pritje të programit dhe procedurave të regjistrimit të cilat shpallen nga organet përkatëse në Ministri. Aktualisht nuk ekziston asnjë program aktiv në Serbi që të ofrojë mbështetje për LAG-et e themeluara.

LAG 321 Čoka, SERBIA

Boris Ilic është ekspert lokal në fushën e zhvillimit rural në Serbi. Ai ka një përvojë të gjatë në koordinimin dhe menaxhimin e projekteve në Bashkinë Čoka, Potiska. Gjatë katër viteve të fundit z. Ilic ka punuar si Drejtor i Infrastrukturës në Komunën Čoka. Në punën e tij si Koordinator i Grupit të Veprimit Lokal ČOKA ai vazhdon të jetë i ekspozuar ndaj çështjeve të zhvillimit rural, me një fokus të veçantë në qasjen LEADER. Fushat e ekspertizës së Z. Ilic përfshijnë: qasjen LEADER; agro-biznesin; eksportin dhe importin; ekonominë e biznesit; menaxhimin e projektit;

LAG 321 Čoka: Territori i partneritetit të LAG-ut përfshin 8 komunitetet e mëposhtme: Čoka, Ostojićevo, Padej, Sanad, Jazovo, Vrbica, Crna Bara dhe Banatski Monoštor. Territori ka një sipërfaqe prej 321 km², me 388 banorë. Vizioni i LAG-ut u përcaktua pas një procesi të gjatë konsultimesh dhe takimesh me aktorë nga sektorë të ndryshëm. Përmes diskutimeve dhe prezantimeve, banorët e komuniteteve lokale filluan të njohin më nga afër mundësitë dhe potencialet e komuniteteve të tyre lokale, të ofrojnë shembuj konkretë të burimeve njerëzore dhe të dakortësohen se zhvillimi lokal duhet të arrihet përmes përdorimit të kujdesshëm të potencialeve territoriale.

Prioritetet e identifikuara për zhvillimin lokal janë: rritja e konkurrencës së prodhuesve në bujqësi, zhvillimi i ekonomisë rurale, përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale, përmirësimi i mirëqënies, koordinimi dhe përafrimi i zhvillimit rural me praktikën e BE-së. Nevojat lokale të adresuara në planin e zhvillimit u identifikuan përmes pyetësorëve, takimeve dhe diskutimeve të pjesëmarrësve. Disa nga nevojat e identifikuara si prioritare janë: edukimi profesional në zonat rurale, brendimi i produkteve lokale, krijimi i vendeve të reja të punës. Në këtë këndvështrim, prioritetet vendore janë: rritja e numrit të prodhuesve bujqësor të specializuar, nxitja e sipërmarrjes, reduktimi i nivelit të ndotjes, përfshirja e qasjes Leader në zhvillimin rural.

DITA 2 E PREMTE, 29 SHTATOR 2017

VENDI: UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

09.30 Regjistrimi i pjesëmarrësve

10.00 SESION PLENAR:

Përfaqësues i lartë nga AICS (Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim):
Mbështetja e zyrës së bashkëpunimit Italian për zhvillimin lokal social dhe ekonomik përmes qasjes nga ‘poshtë-lart’ dhe iniciativave të llojit LEADER.

Prezantimi rezultateve të gjashtë workshopeve tematike

Godina A, Kat.1 Salla “Behar Male”

Workshop 1	Workshop 2	Workshop 3
Prezantues: Shpresim Domi	Prezantues: Amalia Tola	Prezantues: Gentian Mehmeti
Workshop 4	Workshop 6	Workshop 7
Prezantues: Orion Xhoxhi	Prezantues: Ledia Thoma	Prezantues: Rozeta Mihali

11.15 Pushim kafe

11.45 Transferimi i njohurive dhe shkëmbimi i eksperiencave mbi Grupet Lokale të Veprimit, LEADER LAG - rrugëtimi drejt zbatimit të qasjes LEADER në Shqipëri

(Raundi 2)

6 workshope simultane me ekspertë ndërkombëtar LEADER dhe Menaxherë të Grupeve Lokale të Veprimit (LAG) / (Raundi dytë i workshopeve synon të krijojë mundësi për ndërveprim aktiv ndërmjet pjesëmarrësve dhe ekspertëve Leader/ LAG me qëllimin e angazhimit të audiencës në një sistem reflektimi pozitiv, ku eksperiencat më të mira të ndara do të motivojnë pjesëmarrësit të përfshihen në iniciativa konkrete vendore të tipit LEADER.)

Godina B, Kati 3-të

Workshop LEADER LAG 1:	Workshop LEADER LAG 2:	Workshop LEADER LAG 3:
LAG Posavje, SLLOVENI Moderator: Janja Jordan	LAG Srijem, KROACI Moderator: Albert Varga	Iniciativa LEADER në rajonin Göttinger, Gjermani Moderator: Jan Hanisch
(Salla: 304B)	(Salla: 305B)	(Salla: 306B)

	Workshop LEADER LAG 4: LAG Prlekija, SLLOVENI Moderator: Goran Soster (Salla: 307B)	Workshop LEADER LAG 5: LAG Izvor, KROACI Moderator: Matija Zamljačanec (Salla: 308B)	Workshop LEADER LAG 6: LAG Deliblatska Peščara LAG 321 Čoka, SERBI Moderators: Ivana Stefanović & Boris Ilic (Salla: 309B)
--	--	---	--

13.30 PUSHIM DREKEX`

14.30-17:00 Katër GRUPE PUNE simultane – aktorët rajonal dhe vendor iniciojnë diskutimin rreth zbatimit të Leader/CLLD bazuar në katër zonave e zhvillimit rajonal:

Nukleus-et lokale, potencialet territoriale dhe kohezioni territorial – Pjesëmarrësit do të ndahen dhe punojnë në katër grupe sipas katër zonave rajonale:

Godina B, Kati 3-të

GP1. Zona e Zhvillimit Rajonal 1 (Shkodër-Kukës-Lezhë) Moderator: Roland Bardhi Salla: 305B	GP2. Zona e Zhvillimit Rajonal 2 (Tiranë, Durrës, Dibër) Moderator: Shefqet Bruka Salla: 306B	
--	--	--

GP3. Zona e Zhvillimit Rajonal 3 (Korçë-Elbasan-Berat) Moderator: Petrit Dobi Salla:307B	GP4. Zona e Zhvillimit Rajonal 4 (Vlorë-Fier-Gjirokastër) Moderator: Evelina Azizaj Salla:308B	
---	---	--

15.30 - Pushim kafe

16.00

17.00 - Finalizimi i DEKLARATËS së Parlamentit të parë Rural Shqiptar 2017 Grupi i

17.30 punës: përfaqësues nga ANRD dhe UBT

19.30 Darka dhe RRJETËZIM

Ora: 14.300-17.00

Katër GRUPE PUNE simultane – aktorët rajonal dhe vendor iniciojnë diskutimin rreth zbatimit të Leader/CLLD bazuar në katër zonat e zhvillimit rajonal:

Nukleus-et lokale, potencialet territoriale dhe kohezioni territorial – Pjesëmarrësit do të ndahen dhe punojnë në katër grupe sipas katër zonave rajonale:

GP1. Zona Zhvillimore Rajonale 1 (Shkodër-Kukës-Lezhe)

GP1. Zona Zhvillimore Rajonale 2 (Tirana, Durrës, Dibër)

GP1. Zona Zhvillimore Rajonale 3 (Vlorë-Fier-Gjirokastër)

GP1. Zona Zhvillimore Rajonale 4 (Korçë-Elbasan-Berat)

Përshkrim i përgjithshëm dhe objektivat:

Katër grupet e punës synojnë të fuqizojnë qasjen nga “poshtë-lart”, bazuar në potencialet territoriale që zonat rurale janë të pajisura (modeli i zhvillimit endogjen), me qëllimin e inkurajimit të aktorëve lokalë dhe rajonalë për t’u angazhuar në iniciativa të orientuara drejt modeleve pozitive të zhvillimit dhe praktikave të suksesshme. Grupet e punës, gjithashtu, synojnë të krijojnë hapësirë dhe mundësi ndërmjet aktorëve publikë dhe jo publikë për diskutim proaktiv në lidhje me zbatimin e instrumentit të politikave zhvillimore të BE-së, sic është qasja Leader/CLLD, si dhe praktikave pozitive të një qasje të tillë.

Këto diskutime do të pasojnë ndarjen e përvojave të LAG-eve LEADER nga ekspertët e vendeve të rajonit si Sllovenia, Kroaci, Italia dhe Serbia, për t’iu ofruar pjesëmarrësve në parlament mundësinë për përdorimin më të mirë të njohurive dhe përvojave lokale (potencialet lokale në zona kohezive zhvillimore) dhe përfshirjen e tyre në një sistem reagimi pozitiv (transferimi i njohurive dhe ndërtimi i modeleve të reja bazuar në mësimet e nxjerra) me qëllim për të inicuar dhe përforcuar praktikat kuptimplotë dhe të qëndrueshme të transmetuara nga qasja CLLD. Në këtë mënyrë, grupet e punës do të shërbejnë si katalizator për të nxitur iniciativat lokale drejt partneriteteve trepalëshe, duke reflektuar kryesisht modelin e LAG-eve.

Mbi outputet e katër grupeve, organizatorët do të përpilojnë një hartë paraprake të vendit, ku do të jenë të ravijëzuar territoret e mudshme të LAG-eve të ardhshme, dhe identifikuar tematikat e mundshme të zhvillimit të tyre si dhe bërthamëzat lokale mbi të cilat të nisë krijimi i LAG-eve.

Një hartë e tillë i bashkangjitet Deklaratës së përbashkët të Parlamentit të parë rural shqiptar si një shprehje interesi dhe gadishmërie e aktorëve lokal, publik dhe jo-publik, për t'u angazhuar në zbatimin e qasjes LEADER/CLLD në gjithë territorin e vendit.

Kjo për t'i kërkuar Qeverisë së re, si dhe donatorëve të ketë në vëmendje ofrimin e kuadrit ligjor që mundëson krijimin dhe funksionimin e LAG-eve të ardhshme dhe mbështetjen teknike të duhur për të asistuar procesin e krijimit të LAG-eve (ndërtimin e besimit mes aktorëve lokale, krijimin e partneriteteve tripalëshe, formalizimin e partneritetit) dhe draftimin e strategjive zhvillimore lokale të LAG-eve. Një proces i tillë duhet të shkojë dhe të përfshijë cdo banorë në zonat rurale.

Kjo kërkesë mbart në vetvete edhe nevojën për të kuptuar se krijimi dhe funksionimi i Grupeve Lokale të Veprimit është një proces, para se të jetë një output i disa aktiviteteve, dhe si i tillë kërkon kohë dhe lidhshmëri lokale. Në këtë proces është e rëndësishme besueshmëria e aktorëve të ndryshëm lokal dhe po ashtu edhe ndërmjet aktorëve. Si i tillë, ky proces kërkon investim afatgjatë.

E gjithë kjo përpjekje është në linjë dhe mbështet arritjen e objektivave të Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin rural dhe Bujqësor 2014-2020, konkretisht masa: "Përgatitja dhe zbatimi i strategjive lokale për zhvillimin rural – Qasja "Leader", si dhe masën 4 të paketës së parë të masave të parashikuara në Programin IPARD 2014 – 2020.

**DITA 3
E SHTUNË,
30 SHTATOR 2017**
VENDI: PARLAMENTI SHQIPTAR

Sesion Përmbyllës

10.00 Fjala e hapjes

Gramoz Ruci, Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Evelina Azizaj, Koordinatorë Kombëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural

DEKLARATA e Parlamentit të Parë Rural Shqiptar 2017, lexuar nga Martina Dedaj, përfaqësuese e konsorciumit lokal “Fryma e Kelmendit”

Student i Universitetit Bujqësor të Tiranës

Vasillaq Nikolla, përfaqësues i konsorciumit “Pro Përmet”

Almira Xhembulla, anëtare e Parlamentit të Shqipërisë; në emër të grupit “Miq të e Parlamentit Rural”

10:45 **MESAZHET kryesore**

Niko Peleshi, Ministër, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Romana Vlahutin, Ambasadore, Delegacioni i Komisionit European në Shqipëri

Edi Rama, Kryeministër (tbc)

Mesazhet kryesore dhe përmbyllëse

Sesioni parlamentar do të adresojë mesazhet kryesore nga zyrtarët e qeverisë deri te fermerët dhe përfaqësuesit e organizatave lokale. Sesionin final do të nënvizojë mesazhet kyçe për atë që nevojitet për zbatimin e CLLD në drejtim të krijimit të modelit funksional të partneritetit të tipit GLV dhe strategjive të tyre lokale të zhvillimit si një instrument efektiv për zhvillimin e qëndrueshëm lokal të zonave rurale.

Pjesë e rëndësishme e këtij sesioni është edhe lancimi i **Grupit të Miqve të Parlamentit Rural** - si një grup që mbështet këtë nismë në mbledhjet vijuese çdo dy vjet. Grupi ka natyrë honorifike, ad hoc, me fokus lobimin dhe advokimin për politika efektive të zhvillimit rural, të harmonizuara me legjislacionin e BE-së të Zhvillimit Lokal të udhëhequr nga Komuniteti (CLLD), me qëllim që axhenda rurale dhe prioritetet e saj të reflektohen në politikat lokale, rajonale dhe kombëtare. Anëtarësia e grupit do të përbëhet nga personalitete të spikatura të zhvillimeve sociale-ekonomike të vendit duke përfshirë deputetë/ ish deputetë dhe ish ministra, diplomat e politikanë, akademik dhe sipërmarrës etj.

Fokusi i sesionit final do të jetë leximi i **DEKLARATËS** së Përbashkët të Parlamentit të Parë rural Shqiptar 2017 – vizioni për komunitet rurale dhe një grup rekomandimesh që adresojnë përparësitë e zhvillimit të komuniteteve rurale në Shqipëri. Deklarata do t'i dorëzohet përfaqësuesve të qeverisë prezent në sesion si një mënyrë për të siguruar angazhimin e tyre për të avancuar më tej Axhenda Rurale.